



Titulli i projektit

Ofrimi i asistencës për hartimin e strukturës organizative për ZF Lezhë

Tipi i projektit

Administrata Vendore

Vendndodhja e projektit

Zona funksionale Dajç, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Balldre, Zejmen, Kolsh, Shënkoll, Lezhë, Shëngjin

Buxheti i paravlerësuar

30,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Koncepti i zonës funksionale ishte në themel të reformës territoriale që u krye në Shqipëri gjatë vitit 2014. Reforma ka përcaktuar njësi të reja vendore më të mëdha dhe ka krijuar pritshmëri për një zhvillim më koherent dhe përdorim më eficient të burimeve të sektorit publik, por edhe për shfrytëzimin e energjive të sektorit privat.

Në këtë kuadër, njësitë e reja vendore që dalin pas kësaj reforme do të përballen me shumë sfida për komunitetet lokale që ata do të drejtojnë. Për t'u përballur më mirë me nevojat dhe për t'i përkthyer ato në shërbime konkrete për komunitetin, kërkohet domosdoshmërisht harmonizimi i strukturave organizative me funksionet e njësisve vendore. Prandaj, që në ditët e para të qeverisjes së njësisë, një rëndësi primare merr ristrukturimi i saj për t'u përshatur me shërbimet që kjo e fundit ofron për komunitetin.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi i një strukture organizative që t'i përshtatet nevojave të komunitetit dhe të jetë në harmonizim të plotë me funksionet e njësisë vendore dhe zonës funksionale.

Objektivat specifikë janë;

Rritja e cilësisë së shërbimeve duke krijuar një administratë në shërbim të qytetarëve, të shpejtë në ofrimin e shërbimeve dhe të saktë në përbushjen e çdo përgjegjësie të ngarkuar.

Përbushja e objektivave të përcaktuara me ligj;


Rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve financiare, duke mënjanuar dublimet e funksioneve dhe përgjegjësi dhe duke reduktuar kostot e tepërta administrative.

Përshkrime të sakta pune dhe regullore funksionimi.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Nga ky projekt pritet të përfitojnë të gjitha njësitë vendore pjesë e Zonës funksionale dhe komunitetet e tyre. Projekti do të sigurojë:

- Ngritja e kapaciteteve të njësisve vendore;
- Performancë e përmirësuar e strukturës vendore ndarje funksionale dhe vlerësim përgjegjësish sektoriale
- efikasitet në menaxhimin e burimeve financiare;



Aktivitetet e projektit

Projekti do të strukturohet në faza, të cilat do të përfshijnë një vlerësim paraprak të situatës menjëherë pas kompozimit të njësisë së re vendore. Projekti parashikohet të zgjasë jo më shumë se 3 muaj dhe do të finalizohet me miratimin e strukturës dhe paketës rregullatore pranë këshillit të njësisë.

Aktivitetet e projekti përfshijnë kryesisht;

Vlerësimi i situatës aktuale të njësisë vendore dhe legjislacionit. Takime intensive me strukturat aktuale për të kuptuar pozicionin dhe rolin e tyre.

Ngritja e grupit të punës me përbërje nga njësia vendore dhe ekspertë lokalë, i cili duhet të drejtohet nga zv/kryetari i njësisë;

Përcaktimi i detyrave të grupit dhe angazhimit të gjithësecilit;

Rekomandimet e para dhe hartimi i draftit të parë të strukturës organizative, shoqëruar me efektet financiare (për çdo strukturë dhe pozicion);

Finalizimi i strukturës organizative;

Hartimi i projekt-rregullores me përshkrimin e punës për çdo punonjës;

Miratimi pranë Kryetarit

Përgatitja e projekt-vendimit të strukturës dhe rregullores, shoqëruar me efektin ekonomik për t'u prezantuar në KB.

Miratimi.

Vlerësimi i kontratave ligjore që trashëgohen nga shërbimet dhe planifikimi i strukturës së re për organizimin e shërbimeve.

Maturimi i projektit

Projekti është në harmoni me studimin e Zonës Funksionale Lezhë. Ai mund të fillojë menjëherë pas konsolidimit të strukturave të reja vendore, si një kërkesë imediate e njësisë për të ushtruar funksionet e tyre dhe është i thjeshtë për t'u zbatuar si nga njësia vendore, ashtu dhe ekspertët.

Projekti inicion një proces të rëndësishëm që lidhet me zhvillimin e mëtejshëm të njësisë vendore dhe është një kërkesë emergjente e saj.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Për vetë kërkesën imediate dhe afatet kohore të reduktuara, ky projekt mund të mbështetet me grante nga donatorë të ndryshëm, si dldp, etj. Projekti nuk kërkon financime të mëdha pasi është asistencë teknike e vendosur pranë njësisë vendore.

Projekti do të zhvillohet tërësisht pranë njësisë vendore (zona funksionale).

Kostot e projektit

Buxheti i projektit detajohet në shpenzime për burimet njerëzore (konsulenca, shpenzime transporti, bazë materiale, trainime etj.

Struktura organizative – 12,000 Euro

Vlerësimi i strukturës së shërbimeve dhe pasojave ligjore për ndryshimin e kontratave – 15,000 Euro

Takime dhe kosto logjistike të tjera – 3,000 Euro